# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8144
E premte, 19 shtator 2025
Çmimi 0. 50 €


## Me tensione votohen programi dhe përbërja e qeverisë së re të Shqipërisë

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


ISH-KËSHILLTARI LIGJOR I DELEGACIONIT TË KOSOVËS NË RAMBUJE, PAUL WILLIAMS, PËRFUNDON DËSHMINË NË HAGË

# WILLIAMSI: UÇK-ja ISHTE ORGANIZUAR NË FORMË RURALE, JO NË RREGULLA



- Hashim Thaçi dhe delegacioni i Kosovës në Rambuje kërkonin pavarësi

Ish-këshilltari ligjor i delegacionit të Kosovës në Rambuje, Paul Williams, ka përfunduar dëshminë në Gjykatën Speciale në Hagë si dëshmitar i ftuar nga mbrojtja e Hashim Thaçit. Gjatë dëshmisë së tij, Williamsi ka folur për rolin e UÇK-së në Rambuje, pozitën e Thaçit në delegacion dhe procesin e vendimmarrjes brenda strukturave të UÇK-së. Duke folur për strukturën e UÇK-së, Williamsi ka thënë se ishte e organizuar në formë rurale e jo në rregulla. Si rezultat i kësaj, ai ka thënë se ishte krejt e qartë, që komandantët e UÇK-së duhej të bëheshin pjesë e procesit në Rambuje. Ai ka thënë se delegacioni i Kosovës në Rambuje kishte presion nga komandantët lokalë të UÇK-së. Williamsi e ka bërë të qartë se delegacioni i Kosovës në Rambuje në krye me Thaçin kërkonte pavarësi

### KOMANDANTI I FSK-së THEKSON RËNDËSINË E RRITJES SË BASHKËPUNIMIT RAJONAL PËR SFIDAT E SIGURISË F. 3



### GJENDEN SËRISH UNIFORMA USHTARAKE, ANTIPLUMBË DHE KARIKATORË NË VERI, DYSHOHET SE LIDHEN ME SULMIN NË BANJSKË F. 7



## OPINION

### TA PRISHËSH PARTNERITETIN ME SHBA-NË ËSHTË NJËSOJ SI TË PRISHESH ME ZOTIN F. 5

Shkruan: Hajdin ABAZI



### LIRIA E KOSOVËS KA EMRIN HASHIM, I LIDHUR ME AMERIKËN SI ASHTI ME MISH F. 5

Nga Sali BISLIMI



## OPINION



### HARADINAJ: EDHE SOT E VAZHDOJ KOMUNIKIMIN ME CIA-n F. 6

## EKONOMI



### ZËVENDËSGUVERNATORI I BQK-SË MERR PJESË NË IMPACT CEE, NJË NGA KONFERENCAT KRYESORE TË BIZNESIT DHE TEKNOLOGJISË F. 8

## SPORT

### KOSOVA, PËRPARIM HISTORIK NË RENDITJEN E FIFA-s, NGJITET EDHE SHQIPËRIA F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# MACRONI DO TË OFROJË PROVA NË GJYKATË PËR TË VËRTETUAR SE GRUAJA E TIJ ËSHTË GRUA, JO BURRË

PARIS, 18 SHTATOR - Emmanuel Macron dhe gruaja e tij, Brigitte, po planifikojnë të paraqesin prova fotografike dhe shkencore në një gjykatë amerikane për të vërtetuar se zonja Macron është grua.
Avokati i tyre thotë se presidenti francez dhe gruaja e tij do të paraqesin dokumentacionin në një padi për shpifje që kanë ngritur kundër influencueses së krahut të djathtë Candace Owens, pasi ajo promovoi bindjen e saj se Brigitte Macron ka lindur mashkull.
Avokati i Macronit në këtë rast, Tom Clare, tha se zonja Macron i kishte gjetur pretendimet "jashtëzakonisht shqetësuese" dhe se ato ishin një "shpërqendrim" për presidentin francez. "Nuk dua të sugjeroj që kjo e ka nxjerrë nga loja në një farë mënyre. Por, ashtu si çdokush që po përballet me karrierën dhe jetën familjare, kur familja juaj është nën sulm, kjo ju lodh. Dhe ai nuk është imun ndaj kësaj sepse është presidenti i një vendi", tha ai.
Clare tha se do të ketë "dëshmi ekspertësh që do të dalin, të cilat do të jenë të natyrës shkencore" dhe, ndërsa nuk do të zbulonte, në këtë fazë, natyrën e saktë të tyre, ai tha se çifti ishte i përgatitur të demonstronte plotësisht "si në përgjithësi ashtu edhe në mënyrë specifike" se akuzat janë të rreme, shkruan BBC.



"Është jashtëzakonisht shqetësuese të mendosh se duhet të shkosh dhe ta nënshtrosh veten për të paraqitur këtë lloj prove", tha ai. "Është një proces të cilit ajo do t'i duhet t'i nënshtrohet në një mënyrë shumë publike. Por ajo është e gatshme ta bëjë. Ajo është e vendosur të bëjë atë që duhet për ta sqaruar situatën".
Kur u pyet nëse familja Macron do të ofronte fotografi të Brigitte shtatzënë dhe duke rritur fëmijët e saj, Clare tha se ato ekzistojnë dhe do të paraqiten në gjykatë ku ka rregulla dhe standarde. Ndryshe, Owens ka promovuar vazhdimisht pikëpamjen e saj se Brigitte Macron është burrë.

# PEZULLOHET EMISIONI I JIMMY KIMMELIT PËR SHKAK TË DEKLARATAVE TË TIJ RRETH VRASJES SË CHARLIE KIRKUT

UASHINGTON, 18 SHTATOR - Rrjeti televiziv amerikan ABC ka pezulluar emisionin e komedianit Jimmy Kimmel për një afat të pacaktuar pas deklaratave që ai bëri lidhur me vrasjen e aktivistit konservator Charlie Kirk.
Deklaratat e tij nxitën një grup stacionesh të lidhura me ABC-në të deklaronin se nuk do ta transmetonin emisionin e tij.
Kimmel bëri disa deklarata lidhur me reagimet ndaj vrasjes së aktivistit konservator javën e kaluar, gjatë emisionit "Jimmy Kimmel Live", të hënën dhe të martën, përfshirë edhe deklaratën se "shumë njerëz në botën MAGA [Bëje Amerikën Sërish Madhështore] po punojnë shumë për të përfituar nga vrasja e Charlie Kirkut".
ABC, që ka transmetuar emisionin e Kimmelit që nga viti 2003, mori vendimin pasi grupi Nextar Communications, që ka në pronësi një numër stacionesh, tha se do ta ndalte transmetimin e emisionit nga e mërkura.



Deklaratat e Kimmelit për vdekjen e Kirkut "janë fyese, të pandjeshme dhe janë bërë në një moment kritik të diskutimit tonë politik kombëtar", tha Andrew Alford, president i divizionit të transmetimeve në Nextar.
Nextar operon me 23 stacione të lidhura me ABC-në.
Kimmel, kontrata e të cilit me ABC-në përfundon në maj të vitit 2026, ende nuk ka reaguar. Ndërkaq, në njoftimin e ABC-së nuk u përmendën arsyet se pse u ndalua emisioni.
Presidenti amerikan Donald Trump mirëpriti vendimin dhe shkroi në Truth Social: "Urime ABC-së që, më në fund, pati kurajë të bëjë atë që duhej bërë".
Ndërkaq, kreu i Komisionit Federal të Komunikimit të Shteteve të Bashkuara, Brendan Carr, kishte thënë, para këtij vendimi, se deklaratat e Kimmelit ishin "të neveritshme" dhe shtoi se agjencia ka një rast të fortë për ta mbajtur Kimmelin, ABC-në dhe rrjetin partner, Walt Disney Co., përgjegjës për përhapje të dezinformatave. Ai tha se Kimmel dukej se po bënte përpjekje të qëllimshme për ta mashtruar publikun lidhur me vrasjen e aktivistit Kirk, mbështetës i Trumpit.
Gjatë monologut të hënën mbrëma, Kimmel kishte sugjeruar se dorasi i dyshuar i Kirkut, Tyler Robinson, mund të ketë qenë pro Trumpit. "Banda MAGA me dëshpërim po tenton ta paraqesë këtë person, që e vrau Charlie Kirkun, si diçka tjetër e jo si njërin prej tyre, dhe po bën gjithçka për të fituar pikë politikë nga kjo ngjarje", kishte deklaruar Kimmel. "Kjo është çështje shumë serioze për Disneyn", kishte pohuar Carr. "Këto kompani mund të gjejnë mënyra për të ndërmarrë veprime ndaj Kimmelit, ose agjencia do të ndërmarrë masa", kishte thënë ai.
Autoritetet thonë se sulmuesi i dyshuar i Kirkut u rrit në një familje konservatore në Juta, por ishte përfshirë "në ideologji të majtë".
Prindërit e tij u kanë thënë hetuesve se ai ndryshoi ideologjinë politike vitin e kaluar dhe mbështeti të drejtat e komunitetit LGBTQ. Ai i kishte thënë partnerit të tij transgjinor se e kishte vrarë Kirkun sepse "nuk mund ta duronte më urrejtjen e tij". Pak kohë më parë emisioni i një tjetër komediani, Stephen Colbert, u ndërpre nga rrjeti CBS, i cili përmendi arsyet financiare që gjoja qëndrojnë prapa vendimit të tij. Por, disa kritikë kanë thënë se Trumpi mund të ketë pasur rol në këtë vendim. Colbert dhe Kimmel kanë pasur në shënjestër Trumpin gjatë emisioneve të tyre.
Trumpi i ishte gëzuar ngjashëm ndërprerjes së emisionit të Colbertit.

## Kina thotë se bota është në "udhëkryq mes paqes dhe luftës"

Pekin, 18 shtator - Kina ka paralajmëruar kundër ndërhyrjes në çështjet e saj dhe kundër konflikteve të mëtejme, teksa tensionet rajonale janë rritur. "Bota sot qëndron përballë një tjetër udhëkryqi: paqe apo luftë, dialog apo konfrontim", tha ministri i Mbrojtjes, Dong Jung, gjatë ceremonisë hapëse të forumit Shiangshan në Pekin më 18 shtator. Ai tha se Tajvani është pjesë e Kinës, duke shtuar se Ushtria e Kinës është një forcë e fuqishme, e aftë ta mbrojë "ribashkimin".
Pekini kurrë nuk do të lejojë që përpjekjet e Tajvanit për pavarësi të kenë sukses, tha Dong. Ai shtoi se Kina është e përgatitur të zmbrapsë çdo "ndërhyrje të huaj ushtarake" në çdo kohë, duke mos përmendur emra shtetesh në të cilat aludonte se mund të bënin një ndërhyrje të tillë.
Tajvani, shtëpi e 23.4 milionë personave, ka qeveri të veten që nga viti 1949. Megjithatë, Kina pretendon se ai është pjesë e territorit të saj dhe shpesh kërcënon se mund ta marrë atë, duke mos e përjashtuar as përdorimin e forcës.
Shtetet e Bashkuara, mbështetësi kryesor i Tajvanit, është ligjërisht e detyruar t'i mbështesë kapacitetet mbrojtëse të ishullit vetëqeverisës, sipas Ligjit për Raporte me Tajvanin të vitit 1979.
Për shkak të mosmarrëveshjeve, veçanërisht me Filipinet, mbi zonat e pasura me burime në Detin e Jugor të Kinës, Dong theksoi se Kina do ta mbrojë sovranitetin e saj territorial si dhe të drejtat dhe interesat e saj.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# ME TENSIONE VOTOHEN PROGRAMI DHE PËRBËRJA E QEVERISË SË RE TË SHQIPËRISË

**Tiranë, 18 shtator** - Me tensione në Kuvendin e Shqipërisë, deputetët kanë votuar për programin politik për periudhën 2025-2029 dhe përbërjen e qeverisë së re të udhëhequr nga Edi Rama. Ky është mandati i katërt i Ramës në krye të ekzekutivit shqiptar, pasi subjekti i tij, Partia Socialiste, fitoi zgjedhjet e 11 majit.
Kryeministri shqiptar, Edi Rama, doli në foltore për ta paraqitur programin. Por, tensionet u rritën pasi në sallë u lëshua një adresim i Diellës, ministres së shtetit për Inteligjencë Artificiale.
Diella është një bot i inteligjencës artificial. Qeveria Rama 4, së bashku me Diellën, ka 17 ministra. Kjo u kundërshtua nga partitë opozitare, duke bërë që seanca të shkonte në pushim për 15 minuta.
Partia Socialiste kërcënoi se programi nuk do të paraqitej dhe nuk do të kishte debat për të, por do të hidhej direkt në votim.
Pas rinisjes së seancës plenare, kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, e hodhi në votim programin, që mori 82 vota për.
Gjatë votimit elektronik, deputetë të Partisë Demokratike u afruan drejt vendit ku gjenden ministrat dhe hodhën rregulloren e Kuvendit dhe një shishe uji drejt Ramës dhe kreut të ri të Kuvendit, Niko Peleshi.
Kjo është hera e parë që një program i ekzekutivit nuk paraqitet para deputetëve dhe nuk ka debat për të, por hidhet drejt në votim.
Seanca zgjati vetëm 25 minuta, ndonëse ishte parashikuar të zgjaste 25 orë dhe të zhvillohej debat lidhur me programin.
Pas seancës, Rama shkroi në



“Facebook” se duhet që deputetët e zgjedhur të mund të debatojnë në Kuvend të papenguar. Ai tha se 83 ulëset e fituara nga Partia Socialiste në zgjedhjet e 11 majit janë detyrim ndaj votuesve “për t’i vënë një kufi të pakalueshëm kujtdo që në sallën e Parlamentit përdor duart, këmbët, trupin si argument dhe zhurmën apo sharjet e rrugës si alternativë opozitare”.
Ndërkaq, gjatë adresimit të shkurtër në Kuvend, para se të tensionohej situata, Rama tha se mandati i katërt përkon me planin që Shqipëria të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian.
“Shqipëria 2030 në BE është kryefjala e këtij mandati. Shqipëria evropiane është busulla orientuese e çdo faqeje të programit tonë dhe metronomi i ritmit të çdo reforme që do të ndërmarrim”, tha Rama.
Tirana synon që të bëhet pjesë e BE-së më 2030.
Shqipëria hapi kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim në BE në tetor të vitit 2024. Kjo ndodhi pas një pritjeje të gjatë, pasi vendi kishte aplikuar për anëtarësim më 2009 dhe kishte marrë statusin e vendit kandidat në vitin 2014.
Vendi duhet të hapë dhe të mbyllë gjithsej 33 kapituj për t’u anëtarësuar në BE. Për hapjen dhe mbylljen e çdo kapitulli kërkohet miratimi i të gjithë vendeve anëtare të bllokut evropian.

# OSMANI BISEDON ME DIPLOMATIN AMERIKAN HANRAHAN PËR RUAJTJEN E MARRËDHËNIEVE KOSOVË - SHBA

Prishtinë, 18 shtator - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar se ka zhvilluar një bisedë telefonike me diplomatin amerikan Brendan Hanrahan, për rëndësinë e ruajtjes së aleancës “sonë të fortë”, pak ditë pasi ShBA-ja njoftoi për pezullimin pa afat të dialogut strategjik që Osmani shpresonte ta finalizonte këtë vit.
Osmani shkroi në “X” se me Hanrahanin, i cili është zyrtar i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit për Çështje Evropiane, bisedoi edhe për të garantuar “koordinim të ngushtë me partnerin tonë kryesor”.
“Aleanca e fortë me ShBA-në ka qenë gjithmonë në dobi të popullit tonë, sigurisë kombëtare, stabilitetit rajonal dhe integrimit euroatlantik”, theksoi ajo. Ajo u zotua se si presidente e vendit do të angazhohet me administratën e presidentit Donald Trump “për të ruajtur dhe mbrojtur aleancën tonë të bazuar në besim dhe



bashkëpunim të ndërsjellë”.
Marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara morën një goditje javën e kaluar, kur kjo e fundit njoftoi më 12 shtator se e pezulloi dialogun e planifikuar strategjik me Kosovën, duke arsyetuar vendimin me veprimet e qeverisë në detyrë dhe me rritjen e tensioneve dhe paqëndrueshmërisë në vend.
Qeveria në detyrë e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, i hodhi poshtë kritikat e ShBA-së, duke thënë se “veprimet tona, të ligjshme dhe kushtetuese, përgjatë gjithë kohës kanë qenë në shërbim të eliminimit të vatrave të destabilitetit”.
Ishte vetë Osmani që njoftoi në janar se dialogu strategjik do të finalizohej së shpejti. Pas vendimit të ShBA-së, Osmani tha se marrëdhëniet e Kosovës me Uashingtonin janë “pjesë jetike të shtetit dhe identitetit tonë kombëtar”, duke shprehur, njëkohësisht, keqardhje dhe shqetësim të thellë për vendimin.
Dialogu strategjik është një proces që Departamenti Amerikan i Shtetit në shumicën e rasteve zhvillon me vende të ndryshme të botës me synim avancimin e marrëdhënieve bilaterale.
ShBA-ja nuk kishte shpjeguar se cilat kanë qenë veprimet e qeverisë që çuan në vendimin e saj për ta pezulluar pa afat dialogun e planifikuar strategjik.
Megjithatë, të mërkurën në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, ish-ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, shpjegoi se pezullimi erdhi si pasojë e një grumbullimi frustrimesh ndaj qeverisë së kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, ku veçanërisht ndikoi kritika e tij ndaj Gjykatës Kushtetuese.
Kurti e ka kritikuar Gjykatën Kushtetuese për njëanshmëri, duke thënë se ajo është e afërt me partitë shqiptare që mandatin e kaluar ishin në opozitë.
Gjykata Kushtetuese vendosi masë të përkohshme përmes së cilës ua ndaloi deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të ndërmarrin veprime deri më 30 shtator, si dhe ua ndaloi zhvillimin e ndonjë procedure për formimin e qeverisë së re.
Gjykata e vendosi këtë masë në mënyrë ex officio dhe në bazë të kërkesës së deputetëve të Listës Serbe.
Kushtetuesja dhe bashkësia ndërkombëtare e kanë dënuar trysninë e Kurtit dhe partisë së tij ndaj gjykatës më të lartë të vendit.

# KOMANDANTI I FSK-së THEKSON RËNDËSINË E RRITJES SË BASHKËPUNIMIT RAJONAL PËR SFIDAT E SIGURISË

**Prishtinë, 18 shtator** - Konferenca e 28-ta me radhë është realizuar në Tiranë. Në të ishin pjesëmarrës shefat e mbrojtjes të vendeve fqinje dhe agjutantët e përgjithshëm të gardave kombëtare të cilët kanë partneritet me shtetet përkatëse të rajonit. Kjo konferencë është udhëhequr nga komandanti i Komandës Amerikane për Evropë (EUCOM), komandanti suprem i Forcave Aleate për Evropë (SACEUR) dhe bashkëkryesuar nga Shqipëria dhe Bosnjë-Hercegovina.
Në margjinat e këtij konference u theksua rëndësia e rritjes së bashkëpunimit rajonal në favor të ballafaqimit me sfidat e sigurisë.
Gjithashtu, u diskutua edhe rëndësia e bashkëpunimit civil-ushtarak, në kontekstin e adresimit të sfidave të sigurisë shumëdimensionale.
Gjatë adresimit, Jashari edhe kësaj radhe theksoi nevojën dhe rëndësinë e anëtarësimit të Republikës së Kosovës si anëtare me të drejta të plota në këtë nismë. Ky veprim do të sillte më shumë paqe dhe siguri në Ballkanin Perëndimor.
Po në kuadër të konferencës, KOMFSK ka realizuar takimet bilaterale me komandantin e Komandës Amerikane për Evropë (EUCOM), njëherësh komandantin suprem të Forcave Aleate për Evropë (SACEUR), gjeneral Alexus G. Grynkewich, si dhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingjin.
Në fund të konferencës të gjitha shtetet pjesëmarrëse u pajtuan që nisma të tilla i shërbejnë sigurisë rajonale dhe adresimit të sfidave të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor.





ISH-KËSHILLTARI LIGJOR I DELEGACIONIT TË KOSOVËS NË RAMBUJE, PAUL WILLIAMS, PËRFUNDON DËSHMINË NË HAGË

# WILLIAMSI: UÇK-ja ISHTE ORGANIZUAR NË FORMË RURALE, JO NË RREGULLA

## - Hashim Thaçi dhe delegacioni i Kosovës në Rambuje kërkonin pavarësi

Ish-këshilltari ligjor i delegacionit të Kosovës në Rambuje, Paul Williams, ka përfunduar dëshminë në Gjykatën Speciale në Hagë si dëshmitar i ftuar nga mbrojtja e Hashim Thaçit. Gjatë dëshmisë së tij, Williamsi ka folur për rolin e UÇK-së në Rambuje, pozitën e Thaçit në delegacion dhe procesin e vendimmarrjes brenda strukturave të UÇK-së. Duke folur për strukturën e UÇK-së, Williamsi ka thënë se ishte e organizuar në formë rurale e jo në rregulla. Si rezultat i kësaj, ai ka thënë se ishte krejt e qartë, që komandantët e UÇK-së duhej të bëheshin pjesë e procesit në Rambuje. Ai ka thënë se delegacioni i Kosovës në Rambuje kishte presion nga komandantët lokalë të UÇK-së. Williamsi e ka bërë të qartë se delegacioni i Kosovës në Rambuje në krye me Thaçin kërkonte pavarësi

EPOKA E RE Lirim GECI

**HAGË, 18 SHTATOR** - Paul Williams, që ishte këshilltar ligjor i delegacionit të Kosovës gjatë negociatave në Rambuje më 1999, ka përfunduar dëshminë dyditore para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, ku ka folur për rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Rambuje, pozitën e Hashim Thaçit në delegacion dhe procesin e vendimmarrjes brenda strukturave të UÇK-së.

Williamsi në ditën e parë ka dëshmuar për procesin vendimmarrës të delegacionit të Kosovës, objektivat e tij dhe diskutimet mbi demilitarizimin/transformimin e UÇK-së. Ai ka thënë se vëzhgimet e tij e çuan në përfundimin se "Hashim Thaçi nuk kishte autoritet ta nënshkruante marrëveshjen pa miratimin e komandantëve rajonalë".

Duke folur për strukturën e UÇK-së, Williamsi e ka përshkruar atë si ad hoc dhe të decentralizuar, me ndikim të madh të komandantëve vendorë dhe "peshë ideologjike" të veprimtarit politik dhe aktivistit për të drejtat e njeriut, Adem Demaçi. "Nuk kam qenë në dijeni të kësaj dhe do të isha habitur shumë nëse do të kishte ekzistuar diçka me shkrim dhe është një strukturë mbi baza rurale dhe nuk ju vjen në mendje, mendoj ky nivel ndërveprimi, dhe do të kishte qenë shumë me normat kulturore, më shumë autoritet dhe më pak e bazuar në rregulla", ka thënë dëshmitari. Si rezultat, ai ka thënë se ishte krejt e qartë që komandantët duhej të bëheshin pjesë e procesit në Rambuje. "U bë e qartë si drita e diellit se komandantët e zonës duheshin të bëheshin pjesë e procesit", ka thënë Williamsi.

Ai ka dëshmuar se Thaçi shpesh merrte telefonata të shpeshta nga jashtë dhe se ndikohej dukshëm nga komandantët lokalë dhe diaspora, përfshirë kontakte në fshatin Rambuje jashtë kompleksit. "Ai u përgjigjej telefonatave të tyre, bisedonin për një periudhë kohe dhe kishte reagime nga ai në këtë proces, nga të cilat unë nxora përfundimin se ai ishte i përgjegjshëm dhe nënshtrues", ka thënë Williamsi gjatë përgjigjeve ndaj pyetjeve të mbrojtjes së Thaçit.

Williamsi ka thënë se, sipas asaj që i ishte thënë, Thaçi kishte udhëtuar edhe në Slloveni për t'u takuar me Adem Demaçin, për ta siguruar përkrahjen e tij, por ai nuk ka raportuar sjellje kërcënuese në mbledhjet ku ishte i pranishëm.

"Ndërsa delegacioni kosovar në Rambuje po bënte përparim të ngadalshëm drejt një marrëveshjeje, kishte presione të jashtme, siç i diskutuam më herët, nga komandantët lokalë. Por kishte edhe presion ideologjik dhe, do të thosha, kulturor nga Adem Demaçi, i cili po krijonte pengesa për ecurinë e negociatave dhe, ndoshta, nëse jo me siguri, po minonte lëvizjen drejt një marrëveshjeje. Prandaj duhej të merrej parasysh dhe të adresohej", ka thënë ai. Ai ka shtuar se për Demaçin çështja kryesore ishte "pavarësia" e Kosovës.

Në ditën e dytë të dëshmisë, Williamsi u është përgjigjur edhe pyetjeve të trupit gjykues. Ai ka thënë se delegacioni i Kosovës në Rambuje kishte rreth 16 anëtarë, duke përmendur, ndër të tjerë, Ibrahim Rugovën, Blerim Shalën, Hashim Thaçin, Rexhep Qosjen, Bujar Bukoshin, Edita Tahirin, Jakup Krasniqin dhe Bajram Kosumin. Ai ka thënë se kryesuesi ishte zgjedhur me shumicë votash dhe se Thaçi ishte përzgjedhur kryetar i delegacionit. I pyetur pse ishte zgjedhur Thaçi në këtë post, Williamsi ka thënë se në delegacion duhej dikush që përfaqësonte UÇK-në.

"Procesi i pavarësisë së Kosovës ishte shumëdimensional. Rugova ishte pacifisti që nuk e hapte gojën pa përmendur pavarësinë. Bukoshi po punonte në mënyrë më të nuancuar me amerikanët dhe evropianët. Ndërkohë, veprimi i aktorëve të armatosur joshtetërorë kishte rëndësi, si në çdo lëvizje për vetëvendosje. E pastaj ishte dimensioni i negociatave të paqes - aty duhej një figurë që përfaqësonte UÇK-në, por që dukej dhe vepronte si diplomat, negociator, partner i besueshëm", ka thënë ai.

Një nga pyetjet kryesore të trupit gjykues për Williamsin ishte nëse, nga pikëpamja juridike, miratimi i komandantëve lokalë ose rajonalë të UÇK-së ishte i nevojshëm për nënshkrimin e një marrëveshjeje nga Thaçi. →

# Williamsi: Thaçi dhe i gjithë delegacioni i Kosovës në Rambuje kërkonin pavarësi

Paul Williams, ish-këshilltar ligjor i delegacionit të Kosovës në Rambuje, gjatë dëshmisë së tij në Hagë, ka thënë se Hashim Thaçi dhe i gjithë delegacioni i Kosovës kërkonin pavarësinë. Këtë deklarim dëshmitari e ka bërë duke u përgjigjur në pyetjet e gjyqtarit Christopher Barthe. "Hashim Thaçi dhe, do të thosha, të gjithë anëtarët e delegacionit shqiptar të Kosovës dhe ekspertët tyre kosovarë, shqiptarë, kërkonin pavarësinë", ka thënë Williamsi. Ai ka shtuar se ka kaluar shumë kohë duke iu shpjeguar se si mund të arrihet pavarësia pa u përmendur në marrëveshje. "Pra, pavarësia ishte e domosdoshme. Kam kaluar shumë kohë duke ua shpjeguar rrugën se si mund ta arrinin pavarësinë në qoftë se fjala pavarësi nuk shkruhej në marrëveshjen e Rambujesë", ka thënë ai. Përveç kësaj, dëshmitari ka thënë se Thaçi kishte studiuar në Zvicër dhe, përveç kësaj, "ai nuk ishte një fshatar nga zonat e thella të fshatrave në kuptimin që nuk dinte si të sillej, po ishte i qytetëruar".

Williamsi ka thënë se nuk ishte në dijeni të ndonjë dispozite apo rregulli të tillë, duke shtuar se do të ishte "shumë i befasuar" nëse do të ekzistonte diçka e shkruar. Sipas tij, procesi ishte "më shumë normativ, kulturor, i bazuar në autoritet dhe pushtet, e më pak në rregulla të shkruara".
Juristi amerikan është pyetur nga trupi gjykues edhe për rolin e Rugovës në procesin e Rambujesë. Ai ka thënë se ishte bërë këshilltar pro bono i delegacionit, me kërkesë të Rugovës, të cilin e ka vlerësuar si figurë e respektuar. "Çdo bisedë e një ndërkombëtari me të fillonte dhe mbaronte me dy fjali: pavarësi dhe mospërdorim të forcës. Rugova luajti një rol të rëndësishëm në Rambuje duke përfaqësuar popullin e Kosovës. Ai mishëronte pacifizmin dhe aspiratën për pavarësi, por nuk ishte negociator", ka thënë juristi amerikan.
Në ditën e parë të dëshmisë, Williamsi e kishte përshkruar veprimtarin politik dhe aktivistin për të drejtat e njeriut, Adem Demaçi, si person me "peshë ideologjike" në UÇK. Demaçi e kishte kundërshtuar marrëveshjen, duke kërkuar që të përfshihej edhe pavarësia e Kosovës.
Në ditën e dytë të dëshmisë ai ka treguar se gjatë procesit në Rambuje, anëtarët e delegacionit e kishin informuar se Thaçi kishte udhëtuar për në Slloveni për t'u takuar me Demaçin, një hap që e përshkroi si "të domosdoshëm politikisht dhe kulturalisht" për t'i zbutur kundërshtimet ndaj marrëveshjes. "Kjo ishte e domosdoshme sepse Demaçi fliste shumë nga jashtë si figurë ideologjike. Thaçi duhej të tregonte se po e angazhonte atë. Nuk kam krijuar përshtypjen se kërkohej miratimi i tij ose një konsultim formal - ishte një hap i nevojshëm për të vazhduar përpara", ka thënë Williamsi, duke shtuar se largimi i Thaçit nga kështjella shkaktoi shqetësime. Gjatë seancës më 18 shtator gjykata ka cituar edhe pjesë nga një dokument i përgatitur nga Williamsi dhe Mark Weller, po ashtu këshilltar ligjor i delegacionit të Kosovës në Rambuje, ku kërkohej bashkëpunim i plotë me Tribunalin për ish-Jugosllavinë (ICTY), përfshirë arrestimin dhe transferimin e personave të akuzuar dhe qasje të pakufizuar për hetime.
Williamsi ka konfirmuar se Thaçi e kuptonte dhe e mbështeste këtë, madje edhe nëse kjo do ta përfshinte hetimin e pjesëtarëve të UÇK-së. Por, i pyetur nëse UÇK-ja ose qeveria e përkohshme kishin bashkëpunuar realisht me Tribunalin për arrestime apo transferime, ai ka thënë se nuk mban mend shembuj konkretë dhe ka shtuar se nuk dëshiron që të spekulojë.
Trupi gjykues i ka paraqitur Williamsit deklarata publike nga fundi i vitit 1998 dhe fillimi i vitit 1999, përfshirë intervista në "Zërin e Kosovës", ku udhëheqës të UÇK-së kritikonin kryeministrin në mërgim të Kosovës, Bujar Bukoshin dhe "institucionalistët" për menaxhimin e fondeve nga diaspora dhe mungesën e mbështetjes për UÇK-në. Williamsi ka thënë se nuk kishte prova për keqpërdorim ose për financim të dezertimeve, por ka pranuar se tensionet për çështjen e fondeve ekzistonin dhe se Lidhja Demokratike e Kosovës i kishte mbledhur kryesisht për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë në sistemin paralel.
Edhe dëshmitari i parë i thirrur nga mbrojtja e Thaçit, ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, gjatë dëshmisë treditore, ka thënë se ish-presidenti i Kosovës kishte rol kryesisht politik dhe se i duhej ta merrte miratimin e komandantëve për çdo vendim të rëndësishëm ushtarak.
Rubini është ballafaquar me pyetjet e prokurorisë dhe me disa deklarata që kishte dhënë më parë rreth këtij procesi gjyqësor dhe aktakuzën ndaj Hashim Thaçit dhe të tjerëve. Ai e ka quajtur të padrejtë mbajtjen për pesë vjet në paraburgim të të akuzuarve, të cilët, sipas tij, janë dorëzuar vullnetarisht. Rubini ka thënë se kjo nuk është drejtësi dhe akuzat janë të pabaza. Ai në dëshminë e tij ka pohuar se nuk kishte kontroll dhe komandë efektive në UÇK. "Duke qenë se i kam parë nga afër liderët e UÇK-së në male dhe bjeshkë, mendoj se asnjë person tjetër jashtë UÇK-së nuk ka pasur këtë mundësi. Duke pasur një ide të qartë për funksionimin e UÇK-së, për tri ditë me radhë kam vëzhguar sjelljen e tyre, kush ishte përgjegjës, kush komandant dhe kush mbështetës", ka thënë ai.
Rubini ka thënë para trupit të prokurorisë se ka të drejtë të japë opinion lidhur me procesin që po zhvillohet në Hagë. "Me këtë njohuri, unë vërtet mendoj se kjo ka qenë e gabuar dhe nuk përbën drejtësi. Nuk jam jurist me profesion, por kam të drejtë të shpreh dhe të them me zë të lartë opinionin tim", ka thënë ai.
Ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, është përgjigjur me "Jo" në pyetjen se a e di se për çfarë ishte themeluar Gjykata Speciale. Por, Rubini ka thënë se e di se kjo gjykatë ishte themeluar "me kërkesë të liderëve evropianë dhe amerikanë". Ai ka thënë se e di për akuzat e ngritura nga Dick Marty në raportin e tij, ku akuzon Hashim Thaçin për trafikim organesh por, sipas tij, këto akuza nuk përfunduan askund. Gjykimi ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit ka nisur në prill të vitit 2023. Në mbrojtje të liderëve të UÇK-së pritet të dëshmojnë edhe disa dëshmitarë të tjerë, përveç Rubinit dhe Williamsit.
Dëshmitari i radhës i thirrur nga ekipi mbrojtës i Thaçit do të dalë para gjykatës më 22 shtator. Në mediet vendore është raportuar se në mesin e dëshmitarëve të mbrojtjes së liderëve të UÇK-së do të jenë edhe Wesley Clark, William Walker, Bernard Kouchner etj. Gjykata Speciale pret që deri në fund të dhjetorit të përmbyllet gjykimi ndaj krerëve të UÇK-së.

# KAMBERI KËRKON KOMISION HETUES NË SERBI PËR VDEKJEN E USHTARËVE SHQIPTARË NË USHTRINË JUGOSLLAVE NË VITET '80

**Prishtinë, 18 shtator** - Shaip Kamberi, përfaqësuesi i shqiptarëve në Kuvendin e Serbisë, ka bërë me dije se ka dorëzuar një kërkesë për themelimin e një komisioni të posaçëm parlamentar për t'i hetuar rastet e vdekjes së ushtarëve shqiptarë në ushtrinë e atëhershme jugosllave gjatë viteve '80.
Kamberi i bëri këtë kërkesë kryetares së Kuvendit të Serbisë, Ana Bërnabiq, në një kohë kur Serbia po përgatitet për ta rikthyer shërbimin e detyrueshëm ushtarak në vend.
Në kërkesë, Kamberi thekson se në Luginën e Preshevës ekziston shqetësim për thirrjen e mundshme të të rinjve shqiptarë për ta kryer shërbimin ushtarak, "pasi e kaluara dhe pasojat e saj ende ndikojnë në vetëdijen kolektive të shqiptarëve".
Në një njoftim në llogarinë e vet në "Facebook", Kamberi kërkoi zbardhjen e vdekjeve të 135 ushtarëve shqiptarë në radhët e Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ) gjatë viteve '80. "Shumë nga këto raste, të regjistruara si 'vetëvrasje', 'aksidente' apo 'shkelje disiplinore', u konsideruan të dyshimta nga familjet e viktimave, të cilat shpesh raportuan shenja dhune mbi trupat e kthyer", tha Kamberi.
Ai tha se mungesa e hetimeve të pavarura dhe transparencës për ato vrasje e ka forcuar bindjen e tyre se "kemi të bëjmë me vrasje me motive etnike dhe politike, në një periudhë kur shqiptarët në APJ përballeshin me diskriminim, stigmatizim dhe armiqësi të hapur". "Ky fenomen ka mbetur i heshtur e i padokumentuar në diskursin publik në Serbi, duke reflektuar një mungesë serioze të përballjes me të kaluarën dhe të diskriminimit institucional ndaj shqiptarëve", theksoi ai.
Kamberi theksoi se, komisioni, nëse miratohet, do të përfshinte edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe të komunitetit shqiptar.



# LIRIA E KOSOVËS KA EMRIN HASHIM, I LIDHUR ME AMERIKËN SI ASHTI ME MISH

## - Jemi hy në luftë për paqen



Nga Sali BISLIMI

Imagjinata e Gjykatës Speciale, e ndërtuar mbi fantazma, do të bjerë sikur ajo superimagjinatë e Dick Martit!
Miq të mi, të dashur Dardanë. Nuk xhelozohen Gjergj Kastrioti, as Ismail Qemaili, as Hashim Thaçi; këta janë vetëm për t'u admiruar, sepse siç tha Rubini: "Çka ka Hashimi, nuk kanë të tjerët".
Gjykata Speciale është themeluar nga tradhtarët, nga xhelozët dhe nga njerëzit që nuk donin lirinë e Kosovës. Ishte koha të lindte Kosova. Nuk ishin titistët, as milloshevicët që mund ta ndalonin djalin nga Buroja të zbret në Prishtinë për t'i thënë Milloshevigit: "Mbaroi koha jote" dhe gjithëve atyre që të duan në Kosovë.
Tri ditë në gjykatë nuk ma ndaluan pinzin e UÇK-së. Presidenti Thaçi sot më drejtohet me gisht, me përshëndetjen e tij. Atje brenda takova njerëz që kishin dëgjuar emrin tim. Zonja Griep më merr me fjalë të mira: "Mirë se erdhe!" Një tjetër finlandeze më shoqëron me fjalë të mira. Bisedonim herë pas here në pauzat e shkurtra, ju tregoja për punën time, unë për presidentin që është viktimë e kësaj gjykate. Sigurimi në çdo cep ku ishin më përshëndetnin me simpati, me dorë në zemër.
Një gazetare italiane, e cila përcillte gjykimin për një medium evropian, e ftova për një kafe jashtë mureve të gjykatës. Biseduam shumë për t'u kuptuar më mirë se Hashimi, Kadria, Baci Jakupi dhe Rexha janë njerëzit më perëndimorë që ka Kosova.
Kur më pyeti se kush më financon për punën time, iu përgjigja: askush, ndaj edhe bukën e fëmijëve të mi për të kontribuar për atdheun tim. Nëse është kështu, vërtet jeni i rrallë.
Kisha përshtypjen që ata që mbrojnë atdheun dhe heronjtë e vendit të tyre kanë respektin e të gjithëve.
Lexoja në sytë e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve njerëz me vlera profesionale - apo më dukeshin të tillë, sepse kishin përballë Rubinin. Unë do të kisha guximin të hyja në sallë dhe t'u thosha: "Ma lironi Hashimin".
Lindi pyetja: "Po kush ju pruni këtu, ore?" Përgjigjen e kisha unë: O ata njerëz të poshtër që ka vendi juaj, bashkë me serbin, rusin, turkun, arabin, duke ndërtuar minare për luftë me Perëndimin. Idiotë, tradhtarë, rrencë e të gjithëve bashkë, për ta promovuar politikën e gjenocidit ndaj armiqve tuaj që me shekuj ka bartur vendi ynë.
Me një moment mu kujtua mixha im, i cili ishte mbetur i vetmuar në shtëpi me bagëti. Erdhën barbarët e Arkanit dhe dogjën tri shtëpi. UÇK-ja mbeti pa bukë, duke përjetuar intervenimet e NATO-s për pak shpresë. E sot, këta armiq të popullit shqiptar fantazojnë se po bëjnë praktikën në ndonjë mal me spital modern për trafikim të qenieve njerëzore. O Zot, qelu tokë!
Unë po kthehem nga Amsterdam me shpresën që Zoti është me ne, bashkë me Amerikën, dhe do të fitojmë edhe këtë betejë së shpejti, sikur lirinë e vonuar të Kosovës!

# TA PRISHËSH PARTNERITETIN ME SHBA-në ËSHTË NJËSOJ SI TË PRISHESH ME ZOTIN



Shkruan: Hajdin ABAZI

Dy ngjarje që ndodhën si paralelisht qenë paralajmërimi i dëshmisë së James Rubinit në procesin gjyqësor ndaj ish-liderëve të UÇK-së në Hagë e që mori jehonë gjithandej, dhe thuaja dominoi në medie dhe u bë temë bisede - thuaja në çdo mes, e që bëri disi të mbetej si nën hijen e saj ngjarja tjetër e jashtëzakonshme: ngrirja e raporteve të ShBA-së me qeverinë Kurti, prandaj edhe do t'i kushtojë vëmendje në këtë shkrim.
Kjo shenjë e ngrirjes së raporteve të ShBA-së me Kurtin për mua jo vetëm nuk ishte e befasueshme, po ishte krejt e pritshme dhe madje pak sa edhe e vonuar. Pse ishte kështu, do ta shpjegojë.
Një mik i imi, i cili i lexon shkrimet e mia rregullisht dhe herë nuk pajtohej me atë që shkruaj e më kritikon, e herë si me shaka më thotë "me këtë shkrim, ia ke qëlluar", më mori në telefon. "Ti po më del njëfarë profeti!", duke besuar se po tallej, desha ta dëgjoja shakanë e radhës, ndaj dhe i thashë: "E pse po mendon kështu?". Ai më tha: "Ja, po të tregojë" dhe nisi t'i përmend disa nga shkrimet e mia që m'i ka botuar "Epoka e re". Kur shumëkush ishte ngazëllyer nga veprimet në veri të proklamuara si reciprocitet, ti pate shkruar një artikull me titull "Tensionet për reciprocitetin kërkojnë bashkërendim me aleatët" (24.09.2021), kur pohoje, ndër të tjera se çdo gjë duhet të bëhet me koordinim me ShBA dhe aleatët; dhe unë të pata thënë se "je shkëputë nga realiteti i Kosovës". Të kujtohet? Pastaj artikulli "Dështimet e mëdha në politikën e jashtme që e goditën diplomacinë dhe imazhin e Kosovës" (09.10.2021). Ose artikulli "Populli më pro-amerikan në botë" me lidership me kurd anti-amerikan" (21.12.2021) të pata thënë se e ke ekzagjeruar. Pastaj kur u botua "Kurthet politike të çështjeve të sigurisë që implikojnë gjeopolitika (06.09. 2023), mu dukë se po i hiperbolizoje gjërat. Dhe me artikullin "Për çka po aventurizohet partneriteti me ShBA (20.02.2024) mu pat mbush mendja se t'u ka çakorduar dioptria e racionalitetit dhe se ke nisur të halucionacionosh. Kisha dyshime sepse asnjë reagim publik nuk kishte as aleatët, sa më bëhej se Kurti ishte i koordinuar me ta implicit, një pajtim i heshtur. Por t'i kishe të drejtë, kur unë e plot si unë ishim verbuar nga iluzioni. Prandaj, njëmend po më del një farë profeti, se në vazhdimësi për katër vite e ke thënë këtë dhe ja që doli ashtu sikurse ke thënë ti: po aventurizohet partneriteti me ShBA-në, e këtë tash e bëri publike vetë ShBA-ja. Iu përgjigja se ajo që kam shkruar unë nuk ka asnjë lidhje me punë profetësh, sepse nuk jam njeri që kam vizione përmes të cilave ta shoh atë që do të ndodhë. Krejt ato që i kam shkruar, janë përfundime të analizave që kam bërë, dhe përmes tyre e kam parë kahun e largimet nga partneriteti me ShBA-në.
E mbi të gjitha është tepër e rrezikshme për Kosovën pezullimi i dialogut strategjik nga ana e ShBA-së. Reagimet e para te militantëve të Kurtit, sidomos të disa gjoja intelektualëve logjikëtredhur, sa që thanë se më mirë është për Kosovën kështu!
Erdhi sqarimi se ShBA-ja do të ecë "përpara me qeverinë në detyrë, por na duhet një partner që e kupton nevojën për të shmangur veprimet destabilizuese dhe është i përkushtuar për të çuar përpara stabilitetin rajonal dhe për të mbrojtur të drejtat e të gjithë qytetarëve të Kosovës".
Me fjalë të tjera, po tregohet se masa e ShBA-së me pezullimin e dialogut ishte për shkak se Kurti si kryeministër nuk po i shmang veprimet destabiliziese dhe se nuk është i përkushtuar për t'i mbrojtur të drejtat e të gjithë qytetarëve.
Ajo që po thotë ShBA është se po i tërheq vërejtjen Kurtit që të reflektojë e të ndalet, përndryshe do ta pasojnë masa. Deri këtu e solli Kurti me politikën e tij populiste partneritetin e Kosovës me ShBA-në.
Krahas masave nga BE-ja, tash edhe nga ShBA-ja!
E pra, Kosova pa BE-në nuk ka perspektivë sepse atë e synojmë, kurse pa ShBA-në Kosova e rrezikon veten e vet, domethënë shtetësinë, Republikën, pavarësinë pa të cilat nuk ka dhe nuk mund të ketë sovranitet!
Dhe po qe se shihet rrjedha e ftohjes nga viti 2021 kur filloi me mos përfilljen e Marrëveshjes së Uashingtonit e deri te pezullimi i dialogut strategjik, krejt kjo kishte një kamuflazh të vendosjen e sovranitetit në veri - dhe këtë në kundërshtim me ShBA-në, vendet e QUINT-it dhe NATO-s.
E pra, e kam theksuar disa herë dhe po e rikujtojë edhe kësaj here se Kosova ka përfituar vetëm kur është bashkërenduar me ShBA-në.
Vetëm pse gjatë luftës çlirimtare, ashtu si na patën sugjeruar amerikanët gjithandej dhe edhe mua emisari Holbrooke në vitin 1998, ne u bashkërenduam me ShBA-në, ndodhi mrekullia: intervenimi i NATO-s dhe çlirimi i Kosovës. Kjo është kryevepra kolosale gjeopolitike e UÇK, e cila me aq afinitet u përcaktua për partneritet me perëndimin e sidomos me ShBA-në.
Dhe pikërisht këtë kryevepër të UÇK-së - partneritetin me ShBA-në që jo vetëm solli çlirimin nga Serbia, po edhe shpalljen e pavarësisë dhe e jemi si mburojë në kundrejt gjeopolitikave gllabëruese ruso-serbe, Albin Kurti i ka vënë kazmën. Dhe në gjithçka e ka mbështetur edhe Vjosa si presidente e edhe Donika si ministre e jashtme! Kjo trio po ia rrëmihë partneritetin Kosovës me shpëtimtarin e saj - ShBA-në.
Në politikë nuk ka rastësi, sidomos jo kur partneri jetik të kërkon të bashkërendohesh e ti me fodullëk e refuzon, që domethënë se ke vënë një qëllim aq destruktiv e aq kundër Kosovës sa vetëm Serbia mund ta dëshironte!
Madje, kjo edhe ishte strategji e serbomëdhenjve për ta shkëputur Kosovën nga ShBA-ja.
Ja se si e dizajnonte këtë Dobrica Qosiqi: "Kosova nuk rikthehet me luftë. E vetmja mënyrë për ta rikthyer Kosovën është kur klima anti-amerikane fillo të zë rrënjë në Kosovë. Kur shqiptarët të ndjehen të vetëmjaftueshëm dhe nacionalizmi për të mbajtur e ruajtur pushtet del para strategjisë amerikane dhe evropiane. Shërbimet tona duhet të punojnë e ta ndërtojnë një imazh që e imiton nacionalizmin e verbër të Milloshevigit."
A nuk po e çon Kurti Kosovën pikërisht në përmbushje të kësaj strategjie të shovinizmit serb duke e ngrirë partneritetin me ShBA-në!?
Kush nuk e ka humbur sado pak arsyen, duhet t'i thërrasë mendjes dhe të shohë se ku po e katandis Kosovën politika e Kurtit. Dhe, natyrisht, t'i thotë mjaft dhe ta braktisë. Përndryshe, secili që vazhdon me verbëri në mbështetje të politikës antiamerikane të Kurtit, dashje pa dashje shket në taborin antiKosovë! Është koha e fundit që qytetarët tanë ta kuptojnë këtë të keqe që Kurti po ia shkakton Kosovës.
Të largohesh nga ShBA-ja, të them figurativisht, është si të largohesh nga Zoti!

## Gjenden sërish uniforma ushtarake, antiplumbë dhe karikatorë në veri, dyshohet se lidhen me sulmin në Banjskë

**Mitrovicë, 18 shtator** - Të enjten rreth orës 09:45 Njësia e Hetimeve e Stacionit Policor Zveçan ka hasur në një rimorkio. Pas kontrollit të saj, ka gjetur dy thasë me uniforma, antiplumbë, pesë karikatorë të AK-47 me municion dhe pajisje të tjera ushtarake. “Mjetet e dyshimta të cilat janë konfiskuar janë si në vijim: 1 uniformë ushtarake kamufluese, 5 karikator me 132 fishekë të armës AK-47, 5 fatrolla për mbajtje të karikatorëve në gjoks, 4 pale pantallona ushtarake, 4 jakne ushtarake, 3 fotrolla të radiolidhjeve, 1 antiplumb, 2 rripa brezi ushtarak, 1 jelek taktik, 1 çantë taktike, 1 helmetë e gjelbër, 1 kapelë, dhe 1 dritë rrotative. Në vendin e ngjarjes kanë dalë të gjitha njësitë relevante policore. Të gjitha veprimet e ndërmarra i janë paraqitur Prokurorit të Shtetit i cili ka urdhëruar inicimin e rastit ‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve”. Rasti është nën hetime. Nuk ka persona të arrestuar dhe dyshohet se këto armë i përkasin një personi të dyshimtë, i cili tashmë është në kërkim për rastin Banjska”, ka njoftuar Policia e Kosovës.



# EDHE SOT E VAZHDOJ KOMUNIKIMIN ME CIA-n, THOTË HARADINAJ



**Prishtinë, 18 shtator** - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar në një intervistë të transmetuar në “Klan Kosova”, se edhe sot vazhdon të mbajë kontakte të rregullta me shërbimet amerikane të inteligjencës dhe sigurisë. “Unë kam qenë dhe jam gjatë gjithë kohës në komunikim me institucionet amerikane të sigurisë që e kanë shpëtuar popullin tim, në mënyrë që edhe sot të na mbrojnë”, theksoi Haradinaj teksa komentoi dëshminë e ish-ndihmës sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, para trupit gjykues në Gjykatën Speciale, ku e përmendi komunikimin e tij me Agjencinë Qendrore të Inteligjencës (CIA) gjatë luftës së fundit në Kosovë.
Ish-kryeministri shtoi se është falënderues për ndihmën që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Kosovës: “Nëse do të duhej unë të bëj diçka, ose edhe fëmijët e mi, për institucionet amerikane do ta aprovoja menjëherë, edhe nëse në pyetje do të ishte jeta. Lidhja jonë me Amerikën është lidhje gjaku, sepse ata kanë shpëtuar shumë jetë, shumë njerëz… nëse s’do të ishte ndihma e tyre, ne do të kishim shumë vështirësi”. “Duke e parë natyrën time, si luftëtar dhe si njeri i drejtë - ndoshta jo si politikan i mirë - ata e kanë identifikuar një njeri kredibil, të besueshëm dhe një patriot, sepse ai që nuk e do vendin e vet, nuk mund të jetë mik i mirë”, shtoi Haradinaj.
Ai nënvizoi se s’do të kishte folur për këtë çështje nëse ish-diplomati amerikan nuk do ta kishte përmendur: “Nëse ai nuk do të fliste, as unë s’do të guxoja sepse është ofendim i raporteve. Çështjet e sigurisë nuk janë për publik, nuk janë për shoubiz”.

# KRASNIQI NË DRENAS: MË 12 TETOR NUK KA BALOTAZH

**Drenas, 18 shtator** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, mori pjesë në tubimin madhështor në Drenas, ku u hap zyrtarisht fushata zgjedhore dhe u dha mbështetja e fuqishme për kandidatin e PDK-së për kryetar të kësaj komune, Petrit Hajdari.
Në një atmosferë entuziaste dhe përplot energji, Krasniqi theksoi se zgjedhjet e 12 tetorit do të jenë një fitore e qartë për PDK-në dhe Petrit Hajdarin. “Drenasi më 12 tetor nuk ka balotazh. Ka vetëm fitore. Bindëse. Të madhe. Të pakontestueshme. PDK është numri 191. PDK është Petrit Hajdari. Sepse ka vetëm një Parti Demokratike të Kosovës - partia e Hashim Thaçit, e Kadri Veselit e Jakup Krasniqit. Partia e Petrit Hajdarit, e juve të gjithëve. Partia e Drenasit, e Drenicës, e Kosovës. Është partia e lirisë. Partia e arritjeve të mëdha. Partia e fitoreve të përhershme në Drenas. Dhe me 12 tetor, e kryni punën sepse kemi punë të tjera për balotazh. Në Drenas, balotazhi do të harrohet përgjithmonë”, ka deklaruar Krasniqi.
Ai vlerësoi lart kandidaturën e Petrit Hajdarit, duke e cilësuar atë si njeriun e duhur për ta udhëhequr Drenasin me vizion dhe integritet.
Tubimi në Drenas shënoi një fillim të fuqishëm të fushatës, duke konfirmuar mbështetjen e madhe që PDK dhe kandidati i saj, Petrit Hajdari, gëzojnë në këtë komunë. Pas kryetarit të PDK-së, para qytetarëve foli edhe kandidati për kryetar të komunës së Drenasit, Petrit Hajdari, i cili paraqiti vizionin dhe zotimet për mandatin e ardhshëm.



## Jahjaga kërkon nga Obama forcimin e raporteve pas pezullimit të dialogut strategjik

**Prishtinë, 18 shtator** - Ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, është duke marrë pjesë në një samit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Në margjina të këtij samiti, ajo e ka takuar edhe ish-presidentin amerikan Barack Obama.
Jahjaga ka shkruar në “Facebook” se Obamën e ka falënderuar për mbështetjen e jashtëzakonshme që i ka dhënë Kosovës. “Me ftesë të ‘The Jefferson Educational Society’, sot mora pjesë në samitin global në Erie, Pensilvani, ku do te flas për adresimin e pasojave të luftës gjatë mandatit tim si presidente e Kosovës. Ne margjinat e samitit, pata nderin të takoj presidentin Barack Obama, të cilin e falënderova për mbështetjen e jashtëzakonshme që i ka dhënë Kosovës gjatë mandatit tim, si dhe për përkushtimin e vazhdueshëm të Shteteve të Bashkuara ndaj vendit tonë. Kërkova nga presidenti Obama angazhimin e mëtejshëm në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet ShBA-së dhe Kosovës, të cilat janë sfiduar me pezullimin e dialogut strategjik se fundmi. Kërkova edhe ndihmën dhe përkrahjen e zotit Obama në konsolidimin e shtetësisë tonë në arenën ndërkombëtare”, ka shkruar ajo, duke shtuar se ShBA-ja është aleatja më e madh e Kosovës. “Kosova nuk ka pasur dhe nuk do të ketë kurrë aleat më të madh se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe populli amerikan. Falë këtij partneriteti, ne sot gëzojmë lirinë, pavarësinë, njohjen ndërkombëtare dhe anëtarësimin në shumë organizata botërore. Për këtë mbetemi përjetësisht falënderues”, ka shkruar Jahjaga.



# ZËVENDËSGUVERNATORI I BQK-së MERR PJESË NË IMPACT CEE, NJË NGA KONFERENCAT KRYESORE TË BIZNESIT DHE TEKNOLOGJISË

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Dardan Fusha, mori pjesë si panelist në diskutimin e nivelit të lartë me temën "Mundësimi i së ardhmes: Si rregullatorët përmes transformimit digjital strategjik po hapin dhe integrojnë tregjet", së bashku me përfaqësues nga Banka Kombëtare e Rumanisë dhe Autoriteti Kombëtar Rregullativ i Telekomunikimeve të Rumanisë.
Paneli trajtoi mënyrën se si rregullatorët dhe vendimmarrësit po adresojnë mundësitë dhe sfidat e transformimit digjital në sektorin financiar.
Në ndërhyrjen e tij, zëvendësguvernatori Fusha theksoi rëndësinë e reformave të vazhdueshme në sistemet e pagesave dhe infrastrukturën financiare të Kosovës, duke nënvizuar se transformimi digjital është në qendër të agjendës strategjike të BQK-së.
Ai veçoi miratimin e Ligjit të ri për Shërbimet e Pagesave dhe përgatitjen e kornizës ligjore për anëtarësim në SEPA përmes përafrimit të kuadrit të Kosovës me standardet e BE-së dhe zhvillimin e një sistemi të pagesave të shpejta në bashkëpunim me Bankën e Italisë dhe vendet e rajonit, i konceptuar për të ofruar pagesa më të shpejta, më të sigurta dhe më efikase në kosto për qytetarët dhe bizneset.
Këta hapa strategjikë do t'i shkurtojnë kostot, do t'i lehtësojnë dërgesat nga jashtë dhe



do ta thellojnë integrimin financiar të Kosovës me tregun evropian.
Zëvendësguvernatori Fusha theksoi gjithashtu mundësitë që sjellin financat digjitale për gjithëpërfshirjen financiare, veçanërisht për mundësimin e qasjes më të gjerë në shërbime të sigurta dhe të përballueshme për grupet me qasje të kufizuar në sistemin financiar.
Ai vuri në dukje se BQK-ja po përfiton nga përvojat e vendeve të rajonit dhe tregjeve të avancuara të BE-së, duke i përshtatur zgjidhjet sipas kontekstit vendor të Kosovës. "Qëllimi ynë është të sigurojmë që inovacioni të zhvillohet brenda një kornize që garanton stabilitet, qëndrueshmëri dhe mbrojtje të konsumatorit", theksoi zëvendësguvernatori Fusha.
Diskutimi nënvizoi, gjithashtu, rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve financiarë, të telekomunikimeve dhe të teknologjisë, si dhe sektorit privat, për ndërtimin e ekosistemeve të sigurta dhe inovative që mund ta mbështesin rritjen edhe në periudha me paqëndrueshmëri më të lartë.
Pjesëmarrja e BQK-së në këtë aktivitet riafirmon angazhimin e vazhdueshëm për modernizim, bashkëpunim rajonal dhe përafrim të infrastrukturës financiare të Kosovës me standardet evropiane.

# LANSOHET PLATFORMA E BQK-së PËR KRAHASIMIN E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE FINANCIARE

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Banka Qendrore e Kosovës (BQK), me qëllim të përmbushjes së vizionit për rritjen e transparencës, gjithëpërfshirjes financiare dhe fuqizimit të qytetarëve për marrjen e vendimeve të informuara financiare, ka lansuar zyrtarisht në një ceremoni Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare.
Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, në ceremoninë e lansimit të platformës theksoi se kjo përbën një hap konkret dhe të rëndësishëm drejt avancimit të transparencës dhe fuqizimit të konsumatorëve, i cili u jep përdoruesve një instrument për të krahasuar dhe zgjedhur produktet që u përshtaten më së miri



nevojave të tyre, duke forcuar njëkohësisht besueshmërinë ndaj sektorit financiar si dhe përgjegjshmërinë e institucioneve financiare.
Platforma përmban të dhëna nga 50 institucione financiare, përfshirë bankat, institucionet mikrofinanciare, institucionet jobankare dhe kompanitë e sigurimeve. Ajo pasqyron 17 kategori produktesh, të ndara në 60 nënprodukte dhe 203 ndarje të hollësishme, me mbi 10 mijë informacione për krahasim dhe vendimmarrje.
Platforma është e qasshme në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze përmes faqes zyrtare të BQK-së dhe ofron neutralitet dhe qasje të thjeshtë.
Platforma do të operojë në fazë testuese deri në fund të vitit me qëllim të harmonizimit dhe adaptimit me kërkesat teknike dhe rregullative.
Përveç funksionit informues, platforma do të shërbejë edhe si mjet mbikëqyrës i BQK-së, duke siguruar që institucionet financiare të ofrojnë të dhëna të sakta dhe në përputhje me rregulloret.
Edukimi financiar mbetet një nga prioritetet strategjike të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për t'i zgjeruar njohuritë e qytetarëve lidhur me produktet dhe shërbimet financiare që ata të kenë mundësi të negocimit të kushteve dhe marrjes së vendimeve të mirinformuara.
Ky projekt është realizuar me mbështetjen e Fondit Evropian për Evropën Juglindore dhe të bashkfinancuar nga Bashkimi Evropian.
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me këtë projekt riafirmon përkushtimin e saj për promovimin e edukimit financiar, mbrojtjes së konsumatorit, inovacionit dhe avancimit të komunikimit me të gjitha palët e interesuara, ndërsa mbetet e përkushtuar që në linjë me zotimet strategjike ta avancojë sektorin financiar.

# ASK-ja PO ZBATON CIKLIN E TRETË TË ANKETËS SË TREGUESVE TË SHUMËFISHTË (MICS) NË KOSOVË

PRISHTINË, 18 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), në bashkëpunim me UNICEF-in, me mbështetje financiare të UNICEF-it, Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, UNFPA-së dhe Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, dhe partnerëve të tjerë, po zbaton ciklin e tretë të Anketës së Tregueseve të Shumëfishtë (MICS) në Kosovë.
MICS-i është një anketë globale e ekonomive familjare e cila është realizuar për më shumë se dy dekada në më shumë se 100 vende të botës.
Qëllimi i anketës është të mbledh informata mbi treguesit kryesorë që përdoren për ta vlerësuar situatën e fëmijëve, të rinjve, grave dhe burrave.
MICS-i ofron një gamë të gjerë të informatave të nevojshme për ta monitoruar zbatimin e strategjive kombëtare që synojnë ta përmirësojnë situatën e fëmijëve në Kosovë.
MICS-i zbatohet me dy anketa paralele - një që përfshin rreth 7 300 familje të popullsisë së përgjithshme dhe një tjetër me rreth 1 500 familje nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian.
Të dhënat që mblidhen kanë të bëjnë me zhvillimin e hershëm të fëmijëve, imunizimin, shëndetin, ushqyerjen me gji dhe ushqimin e foshnjave, arsimin e fëmijëve, martesat e hershme, shëndetin riprodhues të grave, kushtet e jetesës së familjeve, përdorimin e energjisë në familje etj.
Në terren, MICS-i zhvillohet nga ekipe të përbëra nga katër deri në pesë intervistues, një mbikëqyrës dhe një matës antropometrik, të caktuar për ta vizituar një numër specifik të familjeve.
Intervistuesit e MICS-it do ta identifikojnë veten duke ua treguar letrën e autorizimit dhe kartat identifikuese të tyre, të lëshuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës. Intervistuesit do t'ua japin fletushkën që ofron një përmbledhje të asaj se çka është MICS-i dhe pse po zhvillohet në Kosovë.
Intervistuesit pritet t'i vizitojnë familjet gjatë periudhës 8 shtator deri më 30 nëntor 2025.
MICS-i është zhvilluar për herë të parë në Kosovë në vitin 2013-2014 dhe është përsëritur më 2019-2020.
Të dhënat e mbledhura nga këto anketa kanë qenë



thelbësore për politikëbërje, planifikim strategjik dhe sigurimin e mbështetjes ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.
Edhe ky raund i MICS-it do të sigurojë informata që do ta mundësojnë matjen e progresit të arritur që nga viti 2020.
Gjithashtu, treguesit e MICS-it do ta informojnë zhvillimin dhe monitorimin e strategjive kombëtare dhe do të përdoren nga të gjitha institucionet relevante të Kosovës dhe partnerët zhvillimorë për vendimmarrje dhe zhvillim të politikave të bazuara në evidencë.
Ashtu siç do ta theksojnë edhe intervistuesit, gjatë intervistave në familje, respondentët sigurohen se çdo gjë që thonë do të mbetet rreptësisht private dhe konfidenciale. Përgjigjet në të gjitha pyetjet do të përdoren vetëm për qëllime analitike/statistikore. Informatat e grumbulluara do të përdoren posaçërisht për t'i kuptuar më mirë çështjet që janë të rëndësishme për mirëqenien e fëmijëve, grave, burrave dhe familjeve, siç janë: kujdesi shëndetësor për fëmijët e porsalindur dhe nënat, të ushqyerit, zhvillimi në fëmijërinë e hershme, arsimimi, karakteristikat e ekonomisë familjare etj.

# MOS E MBIVLERËSONI ALEANCËN AUTOKRATIKE

## Uashingtoni ka ende një ndikim të madh mbi Kinën, Korenë e Veriut dhe Rusinë



Patricia M. KIM

Asnjë moment nuk e ka kapur më qartë ndryshimin e ekuilibrave globalë të pushtetit sesa ai kur Xi Jinping, Vladimir Putin dhe Kim Jong Un ecnin krah për krah mbi qilimin e kuq, në paradën ushtarake të Kinës në fillim të shtatorit. Tre autokratët, pavarësisht historisë së gjatë të mosbesimit reciprok, shfaqën unitet kundër Uashingtonit. Mesazhi ishte i qartë: Kina është në qendër të një blloku anti-perëndimor në rritje, ndërsa Shtetet e Bashkuara duken të përçara brenda dhe të dobësuara jashtë.

Presidenti Trump nuk e ka fshehur kurrë atë që dëshiron nga këta tre: një marrëveshje paqeje me Putinin për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, një marrëveshje tregtare me Xi për të riekuilibruar marrëdhëniet ekonomike SHBA-Kinë, dhe një samit me Kimin për të ringjallur diplomacinë në Gadishullin Korean. Por të tre i kanë refuzuar këto oferta. Në vend që të negociojnë sipas kushteve të SHBA-së, ata po bashkojnë forcat në Pekin, duke treguar jo vetëm gatishmërinë e tyre për të sfiduar lidershipin amerikan, por edhe aftësinë për ta bërë këtë së bashku.

Megjithatë, përtej kësaj shfaqjeje të kujdesshme, Kina, Koreja e Veriut dhe Rusia mbeten partnerë të brishtë. Ajo që i lidh është një afrim taktik, jo besimi apo vlerat e përbashkëta, por pakënaqësitë dhe nevojat e tyre. Historia tregon se ata nuk janë aleatë natyralë. Secili shtet është i kujdesshëm të mos mbërthehet në vorbullën e tjetrit dhe nuk është i gatshëm të sakrifikojë interesat e veta. Dhe secili ende kërkon diçka nga SHBA-ja – një levë që Uashingtoni duhet ta përdorë me mençuri.

### Një treshe e vështirë

Hera e fundit kur Kina, Koreja e Veriut dhe Rusia u rreshtuan kaq ngushtë ishte gjatë Luftës së Koresë — një përvojë që rezultoi e dëmshme për të tre. Për Korenë e Veriut, përpjekja për të pushtuar jugun dështoi dhe e la vendin të izoluar e të varfër. Për Kinën, ndërhyrja u kushtoi qindra-mijëra jetë dhe resurse të shteruara. Dhe më e rëndësishmja, lufta solli një prani të përhershme ushtarake amerikane në rajon dhe i hoqi Pekinit mundësinë për të aneksuar Tajvanin. Mësimi për Kinën: aleanca me partnerë të paparashikueshëm mund të kthehet në barrë.

Pas luftës, dyshimi mes tyre u thellua. Pyongyang akuzoi Pekinin se i la interesat e tij mënjanë gjatë negociatave. Kjo solli spastrim të figurave pro-kineze nga udhëheqja e Koresë së Veriut. Ndërkohë, marrëdhëniet mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik u përkeqësuan deri në ndarje të plotë ideologjike e gjeopolitike. Kjo histori e gjatë tregon se mosbesimi, jo solidariteti, ka karakterizuar gjithmonë marrëdhëniet e këtij trekëndëshi.

### Aleatë vetëm përkohësisht

Sot, mbi 30 vjet pas Luftës së Ftohtë, tre vendet kanë gjetur sërish kauza të përbashkëta kundër SHBA-së. Por nën sipërfaqe, ndarjet mbeten të thella. Pekini synon të ndryshojë rendin botëror pa e shkatërruar, duke dobësuar ndikimin amerikan, por pa humbur përfitimet ekonomike të lidhjeve me Perëndimin. Mbështetja e kufizuar që i ka dhënë Moskës në luftën e Ukrainës është pjesë e këtij kalkulimi. Nëse kostoja do të bëhej shumë e madhe, Kina do të ndryshonte qasje.

Ndërkohë, marrëdhëniet Moskë-Pyongyang po shkaktojnë shqetësim për Pekinin. Rusia po forcon lidhjet ushtarake me Korenë e Veriut, duke i dhënë teknologji dhe duke nënshkruar traktate mbrojtjeje. Kjo e dobëson ndikimin e Kinës në gadishull dhe i shton rreziqet e destabilizimit në kufijtë e saj.

Madje edhe mes Moskës e Pekinit ekziston rivalitet. Disa raportime flasin se shërbimet sekrete ruse e konsiderojnë Kinën "armik" dhe kanë frikë nga synimet e saj afatgjata mbi Siberinë dhe Lindjen e Largët Ruse.

Nga ana tjetër, Kim Jong Un është mjeshtri i lojës në këtë treshe. Ai i shfrytëzon tensionet për të nxjerrë më shumë përfitime, duke u afruar njëkohësisht me Moskën dhe Pekinin, për të mos u bërë i varur nga asnjëri.

### Çfarë duhet të bëjë SHBA-ja

Edhe pse ky afrim i treshes nuk i jep Uashingtonit një avantazh të madh strategjik, ai i lë hapësirë për manovrim. SHBA ka ende levë ndaj secilit prej tyre:

Me Kinën, sepse Pekini kërkon stabilitet ekonomik dhe e shmang konfrontimin e drejtpërdrejtë. SHBA mund të lidhë marrëveshje tregtare me kusht që Kina të kufizojë ndihmën për Rusinë dhe të frenojë Korenë e Veriut.

Me Rusinë, sepse Moska do të ketë nevojë për një "dalje" nga lufta teksa humbjet rriten. Vetëm SHBA, Ukraina dhe aleatët mund t'i ofrojnë Putinit një rrugë negociuese.

Me Korenë e Veriut, sepse ajo kërkon lehtësim sanksionesh dhe njohje ndërkombëtare. Këto gjëra Pekini e Moska nuk ia ofrojnë dot plotësisht. Vetëm një marrëveshje me SHBA mund t'i hapë rrugë ndihmës dhe normalizimit.

Momentet si ai i qilimit të kuq në Pekin janë të krijuara për të tronditur Uashingtonin. Por, nëse SHBA shmang diplomacinë sipërfaqësore, e kupton burimin e ndikimit të saj, dhe e përdor fuqinë e saj ekonomike, ushtarake e diplomatike me disiplinë, ajo mund ta formësojë mjedisin strategjik në vend që thjesht të reagojë ndaj tij. / foreign affairs – **bota.al**




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Shkon Papuqi vjen Rama




**Pejë, 18 shtator** - FC Besa Peja ka njoftuar se me marrëveshje të dyanshme ka ndarë rrugët me trajnerin Fisnik Papuqi. Po ashtu, është larguar edhe ndihmësi i tij, Astrit Imami. "Ju njoftojmë për shkëputjen me marrëveshje të dyanshme të bashkëpunimit me trajnerët Asrit Imami dhe Fisnik Papuqi. Klubi falënderon të dy për kontributin e dhënë dhe ju uron suksese në karrierën e tyre të mëtejshme", ka njoftuar FC Besa Peja.

Klubi nga Peja ka bërë me dije se në vend të Papuqit është emëruar Miftar Rama. "Klubi ynë mirëpret trajnerin Miftar Rama, i cili nga sot i bashkohet familjes sonë verdhezi. Me përvojën dhe përkushtimin e tij, besojmë se do të sjellë energji të reja dhe do të ndihmojë skuadrën tonë në arritjen e objektivave që kemi përpara. Suksese dhe mirëseardhje në këtë rrugëtim të përbashkët!", ka njoftuar FC Besa Peja.

# KOSOVA PËRPARIM HISTORIK NË RENDITJEN E FIFA-S, NGJITET EDHE SHQIPËRIA

Prishtinë, 18 shtator - Kombëtarja e Kosovës e ka bërë një përparim historik në ranglistën e FIFA-s. "Dardanët" e kanë regjistruar pozitën më të mirë ndonjëherë që prej pranimit në UEFA dhe në FIFA.

Ekipi i Franco Fodës e sheh veten në pozitën e 91-të duke përparuar për katër pozita.

"Verdhekaltrit" ishin në vendin e 95-të në renditjen paraprake, por fitorja e madhe ndaj Suedisë e ndihmoi Vedat Muriqin me shokë ta përmirësojnë pozitën në këtë ranglistë përkundër humbjes së thellë nga Zvicra. Kosova i ka 1262.1 pikë, ndërsa gjendet përpara Sirisë dhe prapa El Salvadorit në renditje.

Përparim në këtë renditje ka shënuar edhe Kombëtarja e Shqipërisë, e cila është ngritur për dy pozita. "Kuqezinjtë" tash e shohin veten në vendin e 66 në krahasim me atë të 68 sa ishte në muajin e kaluar.

Ekipi i Sylvinhos i ka grumbulluar 1380.66 pikë dhe gjendet përpara Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Hondurasit. Shqipëria e ka mposhtur Gjibraltarin në miqësore në këtë muaj, 1:0, më pas edhe Letoninë me rezultat të njëjtë në ndeshjen kualifikuese të Botërorit 2026.



# ORARI I XHIROS SË PESTË NË SUPERLIGË, TË GJITHA NDESHJET LUHEN TË DIELËN

**Prishtinë, 18 shtator** - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) është duke vazhduar që të gjitha ndeshjet e Superligës t'i lë në të njëjtën ditë. Albi Mall Superliga e Kosovës do të vazhdojë me xhiron e pestë e cila do të zhvillohet të dielën.

Të dielën me fillim nga ora 15:00 do të luhen pesë duelet e parapara të xhiros së pestë në Albi Mall Superligë. Padyshim vëmendja do të jetë në Podujevë, ku Llapi ende pa fitore pret Ballkanin.




Kampionia e Kosovës, Drita, pret Prishtinën e Re dhe synon që ta marrë fitoren e parë të sezonit pas një starti të dobët.

Ndeshje shumë interesante pritet të jetë edhe ajo në mes të Ferizajt dhe Gjilanit, derisa Malisheva pret Prishtinën. Lideri aktual i kampionatit, Dukagjini, do të ketë punë në udhëtim me Drenicën.

# FC VUSHTRRIA ZGJEDH KRYESINË E RE, RRAHMAN RAMA BËHET KRYETAR

**Vushtrri, 18 shtator** - Klubi i Futbollit Vushtrria ka mbajtur mbledhjen e Kuvendit, ku ka zgjedhur kryesinë e re. Ish-komandanti i FSK-së dhe deputeti i PDK-së, Rrahman Rama, është emëruar kryetar i ri i FC Vushtrrisë. Përfaqësues i klubit do të jetë Fazli Muharremi, ndërsa anëtarë të Bordit janë emëruar: Shaip Mikullovci, Besar Zahiti dhe Rrahman Rama.



## Mourinho zbarkon në Lisbonë: Benfica është një klub i madh



**Lisbonë, 18 shtator** - Jose Mourinho ka zbarkuar sot në Lisbonë për të nisur një aventurë të re në stolin e Benficës. Në aeroportin e Tires tekniku portugez është pritur me shumë entuziazëm nga tifozët dhe gazetarët të cilët mezi prisnin fjalët e para të "Special One".

I emocionuar, Mourinho ka thënë se Benfica është klub i madh ."Nuk e kam menduar dy herë. dhe një sfidë që e kam pritur me dëshirë", ka thënë 62-vjeçari, i cili së fundmi ka drejtuar Fenerbahçen në Superligën turke, rikthehet kështu në vendlindje pas një karriere të gjatë në klubet më të njohura të Evropës si Chelsea, Interi, Real Madridi, Manchester Unitedi, Tottenhami e Roma.

Benfica, që kërkon ta rikthejë shkëlqimin në kampionat ashtu edhe në arenën evropiane, beson se përvoja dhe karizma e Mourinhos janë garancia për sukses. Presidenti i klubit, Rui Costa, ka thënë se ardhja e tij është "një mesazh i fortë për të gjithë rivalët, se Benfica synon trofetë më të mëdhenj".

Në ditët në vijim pritet prezantimi zyrtar i Mourinhos në stadiumin "Da Luz", ku pritet një atmosferë madhështore me mijëra tifozë. Detajet e kontratës do të bëhen publike ndërkohë, por tashmë është e sigurt: rikthimi i tij në Portugali shënon një nga ngjarjet më të rëndësishme të futbollit iberik në vitet e fundit.

# AFATI I FUNDIT PËR LICENCIMIN E KLUBEVE NË BASKETBOLL DERI MË 25 SHTATOR

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka vendosur që afati i fundit për licencimin e klubeve në basketboll është deri më 25 shtator.
FBK-ja njofton tutje se ky vendim e ka për qëllim përcaktimin e afatit të fundit për përmbushjen e kritereve të licencimit nga klubet anëtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në kuadër të përgatitjes për sezonin e ri garues 2025/26.
"Duke u bazuar në propozimin e Sekretares së Përgjithshme, znj. Elvira Dushku, dhe pas shqyrtimit nga anëtarët e Bordit të FBK-së,
Vendim i Bordit të FBK-së i datës 18 shtator për procesin e licencimit të klubeve për sezonin 2025/26

### Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e afatit të fundit për përmbushjen e kritereve të licencimit nga klubet anëtare të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në kuadër të përgatitjes për sezonin e ri garues 2025/26.
Duke u bazuar në propozimin e Sekretares së Përgjithshme, znj. Elvira Dushku, dhe pas shqyrtimit nga anëtarët e Bordit të FBK-së,

### BORDI VENDOSI:

### Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit

Të gjitha klubet që deri më sot nuk e kanë përmbushur dokumentacionin e kërkuar për licencim obligohen që të dorëzojnë dokumentet brenda një afati 5 ditë pune nga data e këtij vendimi (25.09.2025).
Pas këtij afati, klubet që ende nuk i kanë plotësuar kriteret nuk do të kenë mundësi të marrin licencën dhe, si rrjedhojë, nuk do të përfshihen në garat e sezonit 2025/26.



### Parimet e vendimit

Ky vendim bazohet në parimet e:
Barazisë dhe korrektësisë, duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjitha klubet;
Transparencës, duke ofruar afat të qartë dhe të fundit për përmbushjen e kritereve;
Integritetit të garës, duke siguruar që vetëm klubet që i plotësojnë standardet minimale të marrin pjesë në kampionate.

### Zbatimi

Zbatimin e këtij vendimi e bën Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së.
Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i FBK-së.

# STARTI MË I DOBËT I DRITËS NË NJË DEKADË, KRIZA KAPLON KAMPIONIN NË FUQI

Kampioni aktual i Kosovës, Drita, ka nisur sezonin 2025/26 me shumë vështirësi.
Pas katër xhirove të para, gjilanasit kanë arritur të grumbullojnë vetëm dy pikë, duke regjistruar kështu nisjen më të dobët në dhjetë vitet e fundit.
Skuadra e drejtuar nga trajneri Zekirija Ramadani nuk ka arritur të bindë në fushë, duke pësuar dy humbje dhe duke marrë vetëm dy barazime.
Drita u mposht në ndeshjen hapëse nga Ferizaj (1-0), barazoi në udhëtim ndaj Llapit (1-1), më pas ndaj Prishtinës (2-2) dhe në fund pësoi një tjetër disfatë zhgënjyese në shtëpi kundër Drenicës (0-2).
Ky start i zbehtë rikthen kujtimet e sezonit 2016/17, kur



Drita kishte vetëm 3 pikë pas katër xhirove dhe në fund u detyrua të luante barazh për mbijetesë.
Po ashtu, edhe në sezonin 2018/19, kur e kishte nisur me 3 pikë, gjilanasit përfunduan në vendin e katërt dhe mbetën jashtë garave evropiane.
Në anën tjetër, Drita ka treguar shpesh se startet e forta janë pasaportë drejt suksesit. Në sezonet 2019/20, 2021/22 dhe 2024/25, bardhekaltërit kishin mes 9 dhe 10 pikësh pas katër xhirove, duke u pozicionuar menjëherë në krye të tabelës dhe duke mbyllur kampionatin me titull ose pjesëmarrje në Evropë.

**PIKËT E DRITËS PAS 4 XHIROVE NË 9 SEZONET E FUNDIT:**
2016/17 ➞ 3 pikë
2017/18 ➞ 4 pikë
2018/19 ➞ 3 pikë
2019/20 ➞ 9 pikë
2021/22 ➞ 10 pikë
2022/23 ➞ 6 pikë
2023/24 ➞ 8 pikë
2024/25 ➞ 10 pikë
2025/26 ➞ 2 pikë

Rezultatet e deritanishme kanë ngritur shqetësime serioze te tifozët bardhekaltër, të cilët e kanë parë ekipin të mos shfaqë lojën e zakonshme dhe të humbasë qetësinë në momentet vendimtare.
Presioni tashmë është rritur mbi trajnerin Ramadani dhe futbollistët e tij.
Drita do të ketë mundësinë e parë për të reaguar këtë të diel, kur në stadiumin e Gjilanit pret Prishtinën e Re.
Një fitore në këtë takim do të ishte jo vetëm shpëtim moral, por edhe shenjë se kampionët ende nuk e kanë dorëzuar garën për mbrojtjen e titullit.
Kujtojmë që Drita ka arritur një sukses historik, duke u kualifikuar për herë të parë në histori të klubit në fazën e ligës në Ligën e Konferencës. /Telegrafi/

# URDHËR ARRESTI I LËSHUAR PËR ISH-YLLIN E BAYERNIT DHE JUVENTUSIT, KLUBI I NDËRPRET MENJËHERË KONTRATËN

Futbollisti brazilian Douglas Costa është përfshirë në telashe serioze ligjore pasi gjykata në Porto Alegre ka lëshuar një urdhër arresti ndaj tij për mospagim të pensionit ushqimor në vlerë prej gjysmë milioni realësh (rreth 78 mijë euro), raporton Gazzetta dello Sport.
Një situatë e ngjashme i kishte ndodhur dy vite më parë, gjatë periudhës kur luante për Los Angeles Galaxy në MLS, kur u dënua me 30 ditë burg.
Pikërisht nga ajo kohë daton edhe urdhri i tanishëm i arrestit, i cili është i vlefshëm deri në fund të vitit 2025 dhe i jep autoriteteve braziliane të drejtën ta ndalojnë lojtarin në çdo moment.
Problemet e tij janë thelluar edhe në aspektin sportiv. Klubi australian Sydney FC, me të cilin Costa nënshkroi vitin e kaluar, njoftoi se kontrata është ndërprerë me pëlqim të ndërsjellë.
Arsyeja lidhet me pamundësinë e lojtarit për t'u rikthyer në Australi për shkak të çështjeve të hapura ligjore dhe personale në Brazil.
"Sydney FC ka ndërprerë bashkëpunimin me Douglas Costan. Lojtari nuk mund të kthehet në Australi për shkak të problemeve të vazhdueshme ligjore dhe personale në Brazil. Në 25 paraqitje, ai shënoi gjashtë gola dhe dha tetë asistime", thuhet në njoftimin e klubit australian.
Vetë Costa e komentoi situatën përmes rrjeteve sociale, duke shprehur falënderim për eksperiencën e tij në Australi.
"Jam mirënjohës ndaj Sydney FC që më dha mundësinë të luaj këtu. Ka qenë një vit i jashtëzakonshëm. Më vjen keq që nuk mund të kthehem, pasi ka gjëra që duhet të zgjidh në shtëpi, por gjithmonë do ta kujtoj këtë periudhë me gëzim. Faleminderit klubit dhe tifozëve për mbështetjen, kjo është një përvojë që nuk do ta harroj kurrë", ka thënë Costa.
Në kulmin e karrierës së tij, Douglas Costa ka veshur fanellat e



Shakhtar Donetsk, Bayern Munich dhe Juventus, duke treguar shkëndija të një talenti të madh, por pa arritur kurrë ta shfrytëzonte plotësisht potencialin e tij. /Telegrafi

F2.3/BNJ

"PASTRIMI" SH.A. Nr. 06/03/14904 Shtojcë Dt. 18.09.2025 Prishtinë-Pristina

## KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokolli 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokolli 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitat test me nr. protokolli 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 17.09.2025 me numër të protokollit 02/01/717 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

### KONKURS PUBLIK PA TEST (KP/PT)

**Për plotësimin e vendit të punës**

Titulli i Vendit të punës: Punëtor i Bartjes
Nr. i kërkuar: Katër (4) pozita, NJO Podujevë në KRM "Pastrimi" SH.A
Numri i Referencës: **KJ/PT**/NJOP/30/2025
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese: 3 muaj

1. **Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1.1 Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
1.2 Bënë zbrazjen e kontejnerëve në automjet/kamion;
1.3 Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
1.4 Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bënë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
1.5 Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hudhjen e kripës;
1.6 Bënë largjimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre ne kontejnerin përkatës;
1.7 Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
1.8 Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët ti vendosë në vendin paraprak;
1.9 Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
1.10Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
1.11Për punën e tij i raporton Kryepunëtorit të Bartjes në Njësi Operative.

2. **Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:**

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. **Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit**

- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

4. **Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre**

| | |
|---|---|
| Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati | ✓ |
| Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme) | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës) | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme) | ✓ |
| Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme) | ✓ |
| Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës | ✓ |
| Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj | ✓ |

5. **Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:**

**5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:**
* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.
* në recepcionin e kompanisë.

**5.2 Dorëzimi i aplikacionit:**
* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

6. **Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;**

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 19/09/2025 deri me datën 03/10/2025.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

7. **Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.**

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:
- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

8. **Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.**

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

9. **Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:**

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Atdhetare Llapaqi shpall të pavlefshëm diftesat e klasës së X, XI, XII, XIII të Shkolla e Mesme Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë

- Liridona Maxhunaj shpall të pavlefshme dëftesat e shfmu "Selman Riza" Gjakovë.

-Ismet Tahiraj shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu "Zekiria Rexha" Gjakovë nga kl. 1-8.

-Behar Hyseni shpall të pavlefshme diplomën e shm mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Rozvita Deda shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë drejtimi Farmaci.
Berneta Boshnuaku shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Fazli Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu "Dëshmorët e Dushkajes" Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.

- Mërgim Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu "Dëshmorët e Dushkajes" Bardhaniq Gjakovë nga kl. 1-8.

- Adriatik Kokalla shpall të pavlefshme dëftesat e kl 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- "Zivinarska Farma Pilke" shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 811814848.

- Marigona Bahtiri shpall te pavlefshme diplomën me nr. 71 drejtimi Inxhinieri Ekonomike – Master Fakulteti "Isa Boletini" arsyeja ndërrim mbiemri.

- Llabinot Murati shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shmle "Hasan Prishtina".
- Sabit Beqiri shpall te pavlefshme diplomën e shmle "Hasan Prishtina".

- Sanije Ibrahimi shpall te pavlefshme diplomën e shmlt "Arkitekt Sinani" ish shkolla "Boris Kidric".

- Rinor Xhemajli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Edin Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "28 Nëntori" Brodosan.

- "Burim Toast" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811919466 Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për

F2.3 / BNJ

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / a.d.
Nr. 06/03/4904 Shtojcë
Dt. 18-09-2025
Prishtinë-Pristina

## REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D.

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno član 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u KRM "PASTRIMI" a.d., posebno član 11. stav 1.2 i član 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" a.d. A, na osnovu Odluke Upravnog odbora sa br. Protokol 01/14/37 od 02/09/2025, na osnovu Odluke EK br. Protokol 02/01/670 od 29.08.2025. godine, na osnovu Odluke EK o ispitnim pozicijama br. protokol 7096 od 15.11.2024. godine, zasnovan na Odluci od 17.09.2025. godine sa brojem protokola 02/01/717 glavnog izvršnog direktora RPO-a "PASTRIMI" SH. Ah, objavite ovo:

### JAVNI KONKURS BEZ TESTIRANJA (KP/PT)
### Za popunjavanje posla

Naziv posla: Transfer radnik
Ne. Potreban: Četiri (4) pozicije, NJO Podujevo u RPO "PASTRIMI" AD
Referentni broj: **KJ / PT** / NJOP / 30/2025
Koeficijenti/Mesečna plata: Nivo XIII
Trajanje ugovora o radu: Na neodređeno vreme
Probni period: 3 meseca

1. **Dužnosti i odgovornosti:**

1.1 Sakupljali su otpad u određenim oblastima;
1.2 Ispraznili su kontejnere u vozilu / kamionu;
1.3 Očistili su područje oko kontejnera;
1.4 Na osnovu operativnog plana i radnog naloga, čistili su i prali ulice i trotoare;
1.5 Čistili su trotoare i puteve od snega i bacali so;
1.6 Uklonili su mrtve životinje sa puta i stavili ih u odgovarajući kontejner;
1.7 Odgovoran je za ljubaznost prema građanima i korisnicima usluga kompanije;
1.8 On je odgovoran za postavljanje kontejnera na prethodno mesto nakon sakupljanja otpada;
1.9 Brine i odgovoran je za pažljivo korišćenje radnih alata i kontejnera;
1.10Obavlja druge zadatke sa kojima se lider bavi;
1.11 Izveštava o svom radu glavnom radniku za transfer u Operativnoj jedinici.

**2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:**
- ✓ Budite državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poznaje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da obavlja relevantan zadatak;
- ✓ Ne biti osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Imajte veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

**3. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja**
- ✓ Budite oprezni i obratite pažnju na detalje;
- ✓ Sposobnost da rade samostalno;
- ✓ Veštine korisničkog servisa;
- ✓ Poznavanje javne bezbednosti;
- ✓ Sposobnost da dobro rade sa rukama;
- ✓ Fizički oblik i izdržljivost;
- ✓ Sposobnost organizovanja vremena i obima posla;
- ✓ Dobre veštine verbalne komunikacije.

**4. Dokumenti koji se podnose kao deo prijave i kako ih dostaviti**

| | |
|---|---|
| Zahtev za zapošljavanje i CV, popunjen i potpisan od strane kandidata | ✔ |
| Dokaz o školskoj spremi iz obrazovnih ustanova (poželjno) | ✔ |
| Kopije dokaza o zaposlenju (penzijski fond, sertifikat ili ugovor o radu) | ✔ |
| Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno) | ✔ |
| Kopije ouena rada za poslednje dve godine (poželjno) | ✔ |
| Identifikacioni dokument Republike Kosovo | ✔ |
| Potvrda Suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci | ✔ |

**5. Kako se prijaviti na konkurs i poslati prijavu:**
**5.1 Povlačenje službenih obrazaca vrši se:**
* preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalno preduzeće za otpad "Pastrimi" a.d.
* na recepciji kompanije.

**5.2 Podnošenje prijave:**
* Prijava za zapošljavanje, sa popunjenom dokumentacijom, podnosi se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu i
* U slučajevima internih i eksternih takmičenja za tehničke pozicije, to se može uraditi i u fizičkom obliku preko arhive kompanije.

**6. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;**
Javni konkurs traje 15 dana od 19.09.2025. do 03.10.2025. godine.
Rok za prijem prijava je 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće biti razmatrane.

**7. Metod evaluacije i kriterijumi ocenjivanja.**
Postupak vrednovanja sadrži ukupno stotinu (100) bodova, pri čemu je prohodnost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog takmičenja.

Ocenjivanje kandidata se zasniva na:
- ✓ biografije kandidata: do 25 bodova
- ✓ Intervjuisanje: do 75 bodova.

**8. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.**

Svi kandidati će biti obavešteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

**9. Približan kalendar postupka zapošljavanja:**
Faza prethodne verifikacije prijava do 7 dana;
Pismena faza testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.
Objavljivanje rezultata vrši se do 3 dana nakon evaluacije intervjua.

**Napomena**: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji stignu nakon isteka roka za dostavu konkursa, neće biti pregledani.



F2.3/BNJ

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 06/03/1495
Dt. 18.09.2025
Prishtinë-Pristina
Shtojcë

KOMPANIA REGJIONALE PASTRIMI PRISHTINË

## KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokolli 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokolli 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitat test me nr. protokolli 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 17.09.2025 me numër të protokollit 02/01/717 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

**KONKURS PUBLIK PA TEST (KP/PT)**
**Për plotësimin e vendit të punës**

| | |
|---|---|
| Titulli i Vendit të punës: | Shofer i kategorisë C dhe C1 |
| Nr. i kërkuar: | Tre (3) pozita, NJO Podujevë në KRM "Pastrimi" SH.A |
| Numri i Referencës: | **KJ/PT**/NJOP/31/2025 |
| Koeficienti/Paga mujore: | Niveli XI |
| Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: | Me kohë të pa caktuar |
| Periudha Provuese: | 3 muaj |

**1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1.1 Nget automjetin sipas urdhëresës së punës në rajonin që i është përcaktuar nga udhëheqësi;
1.2 Është përgjegjës për udhëtojë nëpër rrugët dhe zona të caktuara për të mbledhur mbeturinat në mjediset e tyre të vendosura sipas planifikimit të kompanisë;
1.3 Kontrollojë mjedisin për të identifikuar mbeturinat që duhet të merren dhe për të siguruar që puna bëhet sipas rregullave të shëndetit dhe sigurisë duke mos penguar komunikacionin;
1.4 Në bashkëpunim me udhëheqësin planifikon rrugët më të efektshme për të mbledhur mbeturinat nga zona që i është caktuar për të minimizuar humbjen e kohës dhe ruajtjen e koston e udhëtimit;
